


# Tregtia e jashtme e mallrave

## Tetor 2023

**Tiranë, më 17 Nëntor 2023:** Në Tetor 2023 eksportet e mallrave arritën vlerën 37 mld lekë, duke u ulur me -4,3 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u rritur me 8,8 %, në krahasim me Shtator 2023. Importet e mallrave arritën vlerën 78 mld lekë, duke u ulur me -6,3 %, në krahasim me një vit më parë dhe duke u rritur me 6,5 %, në krahasim me Shtator 2023. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 42 mld lekë, duke u ulur me -7,9 %, krahasuar me Tetor 2022 dhe duke u rritur me 4,5 %, në krahasim me Shtator 2023.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në këtë dhjetëmujor eksportet e mallrave arritën vlerën 370 mld lekë, duke u ulur me -8,6 % krahasuar me një vit më parë, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 728 mld lekë, duke u ulur me -6,4 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 358 mld lekë, duke u ulur me -4,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2022.

### Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Tetor 2023, në uljen e eksporteve prej -4,3 %, kanë ndikuar grupet: “Tekstile dhe këpucë” me -3,6 pikë përqindje, “Makineri, paisje dhe pjesë këmbimi” me -0,8 pikë përqindje, “Prodhime druri dhe letre” me -0,8 pikë përqindje, etj. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +1,0 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +0,5 pikë përqindje dhe “Produkte kimike dhe plastike” me +0,4 pikë përqindje.

**Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Tetor 2023**




Eksportet, gjatë këtij dhjetëmujori janë ulur me -8,6 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -6,4 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -1,2 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -1,2 pikë përqindje, etj. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Ushqime, pije, duhan” me +1,3 pikë përqindje dhe “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +0,3 pikë përqindje.

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:**

Gjatë muajit Tetor 2023, në uljen e importeve prej -6,3 %, krahasuar me Tetor 2022, negativisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -8,6 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -1,4 pikë përqindje, “Prodhime druri dhe letre” me -0,5 pikë përqindje, etj. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Ushqime, pije, duhan” me +1,3 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +1,1 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +1,0 pikë përqindje, etj.

**Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Tetor 2023**



Si dhjetëmujor, importet janë ulur me -6,4 %, krahasuar me dhjetëmujorin 2022. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -6,3 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,6 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -0,7 pikë përqindje, etj. Ndërsa pozitivisht ka ndikuar grupi: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +3,3 pikë përqindje.

#### **Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere**


Në muajin Tetor 2023, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur ulje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Tetor 2022 janë: Italia (4,2 %), Gjermania (26,2 %), Spanja (40,0 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur rritje më të madhe, janë: Kosova (12,9 %), Greqia (0,7 %), Turqia (202,9 %), etj.

Gjatë këtij dhjetëmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur ulje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (9,4 %), Gjermania (30,7 %), Spanja (6,2 %), etj. Ndërsa vendet me të cilin eksportet kanë pasur rritjen më të madhe, është: Kosova (12,1 %), Greqia (15,5 %), Maqedonia (3,4 %), etj.

Në muajin Tetor 2023, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të importeve, janë: Italia (3,3 %), Turqia (18,0 %), Greqia (26,7 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rritjen më të madhe të importeve, në krahasim me Tetor 2022 janë: Kina (13,7 %), Gjermania (15,5 %), SHBA (5,9 %), etj.

Gjatë këtij dhjetëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (4,0 %), Turqia (25,3 %), Greqia (25,2 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rritjen më të madhe janë: Kina (26,0 %), Gjermania (5,0 %), SHBA (28,9 %), etj.

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Tetor 2023



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 57,4 % të gjithë tregtisë. Në Tetor 2023, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 71,7 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 50,7 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (30,2 %), Kina (8,1 %), Turqia (8,0 %) dhe Gjermania (6,4 %).

Shkëmbimet tregtare, për dhjetëmujorin e parë 2023, me vendet e BE-së zënë 58,4 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Tetor 2023, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 72,8 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 51,1 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (29,5 %), Kina (7,8 %), Turqia (6,8 %) dhe Greqia (6,6 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Tetor 2023

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626		-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2021		369	35,6	801	32,3	-432	46,1
2022		487	32,0	950	18,7	-464	51,2
2020	01 - 20	23	5,3	42	-0,4	-19	54,9
	02 - 20	25	10,6	52	3,9	-27	48,3
	03 - 20	18	-36,0	44	-20,8	-27	40,1
	04 - 20	15	-44,2	36	-36,4	-21	41,0
	05 - 20	22	-22,5	45	-24,2	-23	48,1
	06 - 20	23	-9,6	52	-2,4	-29	44,3
	07 - 20	25	-11,5	57	-5,0	-32	43,3
	08 - 20	19	-3,4	48	-6,7	-29	40,2
	09 - 20	25	1,3	52	0,5	-27	48,2
	10 - 20	27	-0,5	59	0,1	-32	45,3
	Janar – Tetor 20	222	-12,2	488	-9,7	-267	45,4
2021	01 - 21	24	3,1	45	8,4	-22	52,3
	02 - 21	25	-0,9	52	0,9	-27	47,4
	03 - 21	32	78,1	64	45,3	-33	49,2
	04 - 21	29	92,3	63	72,9	-34	45,6
	05 - 21	33	52,7	62	38,4	-29	53,0
	06 - 21	35	50,8	67	28,9	-32	51,9
	07 - 21	32	30,6	72	26,1	-39	44,8
	08 - 21	24	22,5	61	26,2	-37	39,0
	09 - 21	25	1,3	52	0,5	-27	48,2
	10 - 21	34	26,3	77	29,2	-43	44,3
	Janar – Tetor 21	292	31,7	616	26,2	-324	47,4
2022	01 - 22	35	47,5	55	21,1	-20	63,6
	02 - 22	37	50,5	69	31,5	-31	54,3
	03 - 22	48	50,4	84	29,7	-36	57,1
	04 - 22	42	46,6	78	23,7	-36	54,0
	05 - 22	45	36,8	80	28,6	-35	56,4
	06 - 22	46	32,2	81	20,8	-35	56,8
	07 - 22	39	23,0	82	14,1	-42	48,3
	08 - 22	35	48,1	80	30,8	-44	44,2
	09 - 22	39	52,5	88	67,6	-49	43,8
	10 - 22	38	12,5	83	8,6	-45	45,9
	Janar – Tetor 22	404	38,6	778	26,4	-374	52,0
2023	01 - 23	42	20,2	58	5,8	-16	72,3
	02 - 23	38	2,8	69	1,1	-31	55,2
	03 - 23	42	-11,7	81	-3,7	-38	52,3
	04 - 23	34	-19,2	75	-3,9	-41	45,4
	05 - 23	40	-11,7	81	1,2	-41	49,2
	06 - 23	38	-17,3	75	-7,5	-37	50,7
	07 - 23	38	-4,0	71	-13,6	-33	53,7
	08 - 23	27	-21,9	68	-15,0	-40	40,6
	09 - 23	34	-12,8	73	-16,6	-40	45,8
	10 - 23	37	-4,3	78	-6,3	-42	46,8
	Janar – Tetor 23	370	-8,6	728	-6,4	-358	50,8

**Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Tetor 2023**

	Eksporte				Importe			
	Tetor 2022	Tetor 2023	Jan.- Tet. 2022	Jan.- Tet. 2023	Tetor 2022	Tetor 2023	Jan.- Tet. 2022	Jan.- Tet. 2023
<b>Vendet e BE-së</b>	<b>29.380</b>	<b>26.215</b>	<b>298.917</b>	<b>269.118</b>	<b>43.819</b>	<b>39.584</b>	<b>406.061</b>	<b>371.970</b>
Austri	491	580	4.309	3.815	502	632	5.650	6.868
Gjermani	2.363	1.744	28.409	19.691	4.850	5.604	48.626	51.063
Greqi	1.752	1.763	21.330	24.636	6.445	4.722	63.572	47.533
Itali	17.407	16.669	178.139	161.317	18.550	17.938	169.548	162.809
Spanjë	2.035	1.221	16.871	15.832	1.741	1.107	13.605	11.385
Kroaci	308	231	6.173	4.008	853	1.044	8.346	7.664
Të tjera të BE-së	5.024	4.006	43.685	39.818	10.878	8.537	96.715	84.648
Mbretëri e Bashkuar	260	168	1.810	6.155	573	790	6.269	7.103
Kinë	390	1.097	8.292	7.900	7.219	8.207	62.054	78.164
Kosovë	3.126	3.530	30.953	34.694	1.504	1.022	13.288	9.553
Maqedonia e Veriut	1.236	1.092	13.890	14.367	955	1.104	12.873	11.521
Rusi	18	-	43	8	1.120	241	9.601	3.718
SHBA	800	450	12.066	3.682	1.287	1.363	11.223	14.470
Turqi	442	1.338	5.250	4.427	9.541	7.826	94.345	70.513
Ukrainë	15	6	460	1.051	285	573	3.485	3.512
Zvicër	96	166	2.645	3.961	593	966	6.348	11.546
Të tjera	2.448	2.489	30.127	24.440	16.394	16.380	152.924	146.228
<b>Gjithsej</b>	<b>38.211</b>	<b>36.551</b>	<b>404.452</b>	<b>369.803</b>	<b>83.290</b>	<b>78.056</b>	<b>778.470</b>	<b>728.298</b>

**Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Tetor 2023**

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Tetor 2022	Tetor 2023	Jan.- Tet. 2022	Jan.- Tet. 2023	Tetor 2022	Tetor 2023	Jan.- Tet. 2022	Jan.- Tet. 2023
<b>Gjithsej</b>	<b>38.211</b>	<b>36.551</b>	<b>404.452</b>	<b>369.803</b>	<b>83.290</b>	<b>78.056</b>	<b>778.470</b>	<b>728.298</b>
Ushqime, pije, duhan	4.592	4.571	41.178	46.340	11.862	12.978	125.282	121.596
Minerale, lëndë djegëse, en,el,	6.388	6.784	86.893	81.837	15.767	8.636	134.603	85.651
Produkte kimike dhe plastike	1.332	1.494	15.228	13.188	9.845	10.268	96.801	96.053
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	260	190	2.369	2.268	1.609	1.245	14.370	11.775
Prodhime druri dhe letre	1.262	971	11.807	9.440	2.940	2.507	29.318	24.953
Tekstile dhe këpucë	12.170	10.782	111.678	106.813	10.017	8.834	84.380	78.803
Materiale ndërtimi dhe metale	7.266	7.467	92.559	66.536	11.257	12.144	115.136	102.678
Makineri, pajisje dhe pj, këmb,	3.729	3.413	32.325	33.377	16.942	17.768	150.393	176.341
Të tjera	1.211	879	10.417	10.003	3.050	3.676	28.187	30.447

**Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Tetor 2023**

	Itali		Kosova		Greqi		Gjermani	
	2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023
<b>Gjithsej</b>	<b>178.139</b>	<b>161.317</b>	<b>30.953</b>	<b>34.694</b>	<b>21.330</b>	<b>24.636</b>	<b>28.409</b>	<b>19.691</b>
Ushqim, pije duhan	9.388	12.789	4.475	5.496	3.304	3.926	1.464	1.703
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	17.688	8.978	4.702	6.928	3.245	8.012	16.130	6.447
Produkte kimike dhe plastike	4.137	5.060	3.428	3.444	3.042	908	53	43
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	2.170	2.095	12	8	33	54	11	11
Prodhime druri dhe letre	7.123	5.477	1.243	1.025	1.723	1.483	267	107
Tekstile dhe këpucë	87.296	82.996	148	185	4.689	5.831	6.809	8.154
Materiale ndërtimi dhe metale	28.977	21.318	14.116	14.369	4.495	3.474	1.047	1.327
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	16.455	18.043	1.503	1.853	116	128	2.215	1.629
Të tjera	4.906	4.561	1326.6	1.387	683	821	413	270

**Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Tetor 2023**

	Itali		Kinë		Turqi		Gjermani	
	2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023
<b>Gjithsej</b>	<b>169.548</b>	<b>162.809</b>	<b>62.054</b>	<b>78.164</b>	<b>94.345</b>	<b>70.513</b>	<b>48.626</b>	<b>51.063</b>
Ushqim, pije duhan	23.833	24.204	1.235	1.549	5.229	4.950	4.884	4.803
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	3.585	5.713	6	36	8.393	8.239	771	821
Produkte kimike dhe plastike	20.857	19.718	6.187	6.956	10.400	9.916	10.194	9.817
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	11.336	9.486	793	754	468	277	36	98
Prodhime druri dhe letre	6.397	5.653	1.034	1.703	4.978	3.835	1.030	765
Tekstile dhe këpucë	41.013	36.153	10.427	11.164	15.745	11.862	1.817	2.156
Materiale ndërtimi dhe metale	22.119	20.913	7.176	11.537	34.960	17.618	1.857	1.702
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	33.984	33.965	29.204	38.403	9.896	10.319	26.339	29.082
Të tjera	6.425	7.004	5.992	6.062	4.276	3.496	1.700	1.819

# Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

## Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

## Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri